REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1707/4 Prot                                        Rrëshen, më 29 . 05 . 2026

# VENDIM

**Nr. 32 datë 26. 05. 2026**
**PËR**
**MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR SUBJEKTIT "TETE ALBANIA TUNNEL & MINING" SHA, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KTHELLË, NË ADMINISTRIM/PRONËSI TË BASHKISË MIRDITË"**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, nenit 54/e, ligjin nr. 57/2020, "Për pyjet" *i ndryshuar*, VKM nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave /Bashkive"pika 45, të ndryshuar, VKM nr. 888, datë 27.12.2022, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor, VKM nr. 887, datë 19.12.2007, "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shteterore për kullotje dhe kositje", VKM nr. 559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe te kullotave", Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016, i Ministrit të Mjedisit, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pikat 22, 23, dhe 26, Raporti nr. 1707/1, datë 15.04.2026, mbi studimin tekniko - ekonomik për dhënie në përdorim të sipërfaqes pyjore/kullosore në administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë, njësia administrative Kthellë, Relacioni nr. 1707/2, datë 15.04.2026, mbi hartimin e raportit teknik për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor / kullosor Bashkiak, kërkuar nga subjekti **"Tete Albania Tunnel & Mining" Sha**, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas **Konsultimit Publik** e organizuar nga Këshilli Bashkiak me datë 15.05.2026, në njësinë administrative Kthellë, në bazë të Proces-Verbalit nr.1918/10, datë 15.05.2026, *shqyrtimin në mbledhjen e datës 25.05.2026, të Komisionit Bujqësisë, Pyjeve, Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes Mjedisit,* për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

## VENDOSI:

1. Miratimin për dhënien në përdorim të sipërfaqes tokë pyjore/kullosor, prej 1.095 ha gjithësejt, në funksion të zbatimit të projekteve; "Ndërtim rrugë lidhëse dhe kërkim verifikim pikash burime mineral bakri", nga subjekti **"Tete Albania Tunnel & Mining" Sha**, në zonat Perlat-Jugor dhe Perlat-Shebe, njësia administrative Kthellë, përkatësisht në pasuritë fond pyjor, n/ngastra nr. 88b/d, Ekonomia pyjore Selitë, n/ngastra nr. 24b, Ekonomia pyjore Perlat-Shebe, në administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë

2. Afati i dhënies në përdorim do të jetë 2 vjet

3. Në vitin e parë të lidhjes së kontratës; subjekti, paguan në llogarinë e Bashkisë Mirditë, shumën **prej; 129 934** (*njëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër*) lekë

4. Në vitin e dytë e në vazhdim; subjekti, paguan në llogarinë e Bashkisë Mirditë, shumën **prej; 119 734** (*njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër*) lekë

5. Raporti nr. 1707/1, datë 15.04.2026, mbi studimin tekniko - ekonomik për dhënie në përdorim të sipërfaqes pyjore/kullosore në administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë, njësia administrative Kthellë, Relacioni nr. 1707/2, datë 15.04.2026, mbi hartimin e raportit teknik për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor / kullosor Bashkiak, *bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi*

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria Juridike & Agjencia e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve)

*Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

| **SEKRETAR** | | **KRYETAR** |
|---|---|---|
| **Gaspër TOPOLLAJ** | REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË | **Aleksandër PICAKU** |

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA MIRDITE
AGJENCIA E BUJQESISË UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

Nr.1707 Prot. /3 Rrëshen më 17. 04.2026

**P/VENDIM**

Nr 39 datë 17/04/ 2026

**PËR DHËNIE NË PËRDORIM ME KONTRATË QERAJE TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR SUBJEKTIT " TETE ALBANIA TUNNEL&MINING " SH.A NJËSINË ADMINISTRATIVE KTHELLË DHE NË ADMINISTRIM/PRONËSI TË BASHKISË MIRDITË .**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", nenit 54/e, ligjin nr.57/2020, VKM nr.433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave /Bashkive"pika 45, të ndryshuar, VKM në nr 888, datë 27.12.2022, " Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor. VKM-në nr. 887, datë 19.12.2007 " Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shteterore për kullotje dhe kositje", " Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 559, date 29.07.2022 " Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe te kullotave " në Udhëzimin nr.1.datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit " Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik",pikat 22, 23, dhe 26, dhe në " raportin mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim të fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në administrim/pronësi të bashkisë Mirditë të kërkuara për dhënje në përdorim nga shoqëria " **TETE ALBANIA TUNNEL&MINING " SH.A,** Këshilli i Bashkisë pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga N/Kryetari i Bashkisë

**V E N D O S I:**

1. Miratimin për dhënjen në përdorim të sipërfaqes tokë pyjore/kullosor, prej 1.095 ha gjithësej, në funksion të zbatimit të projekteve " Ndërtim rrugë lidhëse dhe kërkim verifikim pikash burime mineral bakri " nga subjekti " **TETE ALBANIA TUNNEL&MINING " Sha,**

në zonat Perlat-Jugor dhe Perlat-Shebe, Njësitë administrative Kthelle, përkatësisht në pasuritë fond pyjor/kullosor, n/ngastra nr.88b/d , Ekonomia pyjore Selitë, n/ngastra nr.24b Ekonomia pyjore Perlat-Shebe, në administrim/pronësi të bashkisë Mirditë.

2. Afati i dhënjes në përdorim do të jetë 2- vjet.

3. Në vitin e parë të lidhjes së kontratës, shoqëria paguan në llogarin e Bashkisë Mirditë, shumën **prej 129 934 lekë.**

4. Në vitin e dytë e në vazhdim shoqëria paguan në llogarin e Bashkisë shumën **prej 119734 lekë**

5. Raportet i studimit tekniko ekonomik përkatës janë pjesë e këtij p/vendimi.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet N/Kryetari i Bashkisë.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**S E K R E T A R** **K R Y E T A R**

**Gasper TOPOLLAJ** **Aleksander PICAKU**

Paraqiten Projektin.

Drejtoria Juridike Majlinda Topollaj

ABUA-Pyjor Drejtori Kastriot Bica

**K R Y E T A R I**

**Albert MËYSHI**

**ME DELEGIM KOMPETENCASH**
**ME VENDIM**
**ZV/KRYETARI**
**Gjergj PRENGA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

Gaspel

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA MIRDITE
AGJENCIA E BUJQESISË UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

Nr. 1704/2 Prot. Rrëshen më 15.04.2026

# RELACION

**Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK**

**MBI HARTIMIN E RAPORTIT TEKINIK PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR BASHKIAK NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KTHELLË SUBJEKTIT " TETE ALBANIA TUNNEL&MINING " SH.A.**

Bazuar në ligjin 57/2020, " Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 559, date 29.07.2022 " Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe te kullotave ", Udhëzimin nr. 01, datë 09.06.2016 " Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kollusor publik ", "Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, paraqet për miratim mundësine e dhënjes në përdorim të fondit pyjor/kullosore, si më poshtë :

1-Siperfaqja e përgjithshme që shtrihet gjurma e projektit është 1.095 ha.

a- Gjurma e rrugës 2.147 km.
b- Vendkërkimi i mineralit të bakrit 0.129 ha.
c- Material drusor (dru zjarri te forta) 17 m3.

Në funksion të zhvillimit të këtij aktiviteti (shfrytëzimin e mineralit të bakrit) gjykohet që ky subjekt duke qenë se ushtron aktivitet në njësinë administrative Orosh dhe ka kontratë ekzistuese me bashkinë Mirditë është në interest të komunitetit dhe institucionit tonë që subjekti ti miratohet dhe projekti i paraqitur për një afat kohor 2-vjeçar referuar kërkesësës së subjektit. **" TETE ALBANIA TUNNEL&MINING " SH.A.**

Bashkëngjitur me këtë relacion, gjenden raporti për miratim listat përkatëse sipas lidhjeve 1, 2 ,3, 4 dhe 5 me të dhënat e siperfaqeve pyjore /kullosore, n/ngastrat pyjore, kategoritë e teritorit, etj .

Konc. P/ Pyjeve dhe Kullotave

Ing. Eneida Nikolli

DREJTORI

Ing.Kastriot BICA

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**

ME DELEGIM KOMPETENCASH

ME VENDIM
ZV/KRYETARI
Gjergj PRENGA

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

SEKRETARIA
BASHKIA MIRDITË

REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA MIRDITE

AGJENCIA E BUJQESISË UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

Nr. 1707/2 Prot. Rrëshen më 15.04.2026

**RAPORT**

**MBI STUDIMIN TEKNIKO – EKONOMIK TË SIPËRFAQES PYJORE/KULLOSORE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË MIRDITË, NJËSIA ADMINISTRATIVE KTHELLË .**

*"Kërkim verifikim pike mineral bakri në zonat Perlat Jugor dhe Perlat Shebe" nga shoqëria; "TETE ALBANIA TUNNEL & MINING" Sh a .*

Në zbatim të Urdhërit nr. 183, datë 14.04.2026 të N/Kryetarit të Bashkisë për hartimin e raportit të studimit tekniko – ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore, kërkuar për dhënie në përdorim në funksion të zbatimit të projektit për kërkim verifikim pike mineral bakri në zonat " Perlat-Jugor dhe Perlat- Shebe " nga shoqëria " TETE ALBANIA TUNNEL & MINING " Sh a, Grupi i punës i përbërë nga; Gjovalin Nikolli, Preng Nikolli dhe Eneida Nikolli, Sektori i Monitorimit dhe Sherbimit Pyjor në Bashki, pasi u njoh me Urdhërin e N/Kryetarit të Bashkisë dhe administroj dokumentacionin teknik të gjurmës së projektit, realizoi verifikimin e gjurmës së projektit në terren, të dhënat në regjistrin kadastral të pyjeve/kullotave bashkiake, dhe planin e rregullimit të territorit të Bashkisë Mirditë, konkludoj si më poshtë:

Sipërfaqja e përgjithëshme që shtrihet gjurma e projektit është rreth 1.095 ha, e ndarë në:
1-Gjurma e rrugës është rreth 0.966 ha, me gjatësi rreth 2147 ml (2.147 km) dhe gjerësi mesatare rreth 4.5 m.

2- Vende kërkim zbulim mineral bakri rreth 0.129 ha

Gjurma e projektit shtrihet tërësisht në fond pyjor/kullosor publik, n/nëngastrat pyjore nr.88 b,d, dhe 89d ekonomia pyjore/kullosore Selitë, dhe n/nëngastrat pyjore nr.24b, ekonomia pyjore/kullosore Perlat -Shebe njësia administrative Kthellë, pasuri këto në pronësi/administrim të Bashkisë Mirditë.

Nga përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi ku kalon gjurma e projektit (formularët 1 dhe 2 bashkëngjitur), rezulton kryesisht tokë me pyll të llojit dushqe, me një shkallë mbulimi rreth 70% të sipërfaqes.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin teknik dhe të verifikuara në terren, nuk e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverisjes dhe treguesit kryesor të sipërfaqes pyjore/kullosore.

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-në nr 888, datë 27.12.2022, " Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor ", dhe në Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr. 01 datë 09.06.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik ".

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, zbatimi i këtij projekti fillon vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Mirditë, dhe likujdimit të tarifës prej **129 934** lekë.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në Vkm-vnë nr. 599, datë 29.07.2022 " Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave ", në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsiston në:

**a)Vlera e përdorimit për sipërfaqe në ha, 12 384 lekë/vit**

Trungishte 0.000 ha x 0.000 lekë = 0.000 lekë

Cungishte 0.129 ha x 96000 lekë = 12384 lekë

Shkurre 0.000 ha x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Bimësi 0.000 ha x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Inproduktive etj.0.000 ha x 0.000 lekë = 0.000 lekë

**a/1) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km, rrugë lidhëse 107 350 lekë/vit**

Trungishte 0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Cungishte 2.147 km x 50000 lekë = 107 350 lekë
Shkurre 0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Bimësi pyjore 0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Inproduktive etj..0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë

**a/2) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km, Linja të tensionit të lartë në** 0.000 **lekë/vit**

Trungishte 0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Cungishte 0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Shkurre 0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Bimësi pyjore 0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë
Inproduktive etj 0.000 km x 0.000 lekë = 0.000 lekë

**b)Vlera e bimësisë pyjore, florës dhe faunës është 10 200 lekë, e përbërë nga :**

1. Vlera e druve të zjarrit 10 200 lekë.
2. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 0.000 lekë
3. Kullotja 0.000 lekë
4. Vlera e faunës 000 lekë
5. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj) 0.000 lekë.
6. Të tjera 0.000 lekë

PËRPILUESIT E KËTIJ RAPORTI

Ing.Gjovalin Nikolli　　Ing. Preng Nikolli　　Ing.Eneida Nikolli

DREJTORI ABUAPYJOR

Ing.Kastriot Bica

**K R Y E T A R I**

**Albert MËLYSHI**

**ME DELEGIM KOMPETENCASH**
**ME VENDIM**
**ZV/KRYETARI**
**Gjergj PRENGA**

SEKRETAR BASHKIA MIRDITË

BASHKIA MIRDITË

PASQYRA E PËRSHKRIMIT PARCELAR (sipas rregjistrit kadastral, inventari i transferimit dhe verifikimit ne terren)

(Për dhënien në perdorim Sipërfaqe Fond Pyjor, në zbatim të projektit të shpimeve verifikuese në zonat Perlat- Jugor nga kompania)
(" **TETE ALBANIA TUNNEL & MINING** " SH.A)

Formulari 1

| ID.i Pronës | Ekonomia pyjore/kullosore | Parcela nr. | Përbërja e grumbullit | Funksioni | Forma e qeverisjes | Të dhëna të grumbullit pyjor | | | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Kl.Moshës | K.D | D mes | H mes | Filizeria | n/pylli | Katet | Për ha | Total |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| LE 33 0088/b | Selitë | 88/b | lis | mbrojtës+prodhues. | cung | III | 0.7 | 8 | 8 | 0 | frash | 0 | 22 | 51 |
| LE 33 0088/d | Selitë | 88/d | lis | mbrojtës+prodhues. | cung | III | 0.7 | 8 | 8 | 0 | dëllinj | 0 | 22 | 418 |
| LE 33 0089/b | Selitë | 89/b | lis | mbrojtës+prodhues. | cung | III | 0.7 | 5 | 6 | 0 | frash | 0 | 10 | 200 |
| LE 31 0024/b | Perlat-Shebe | 24/b | lis | mbrojtës+prodhues. | cung | III | 0.6 | 7 | 8 | 0 | dëllinj | 0 | 15 | 150 |

PLOTESOI: Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI ABUAPYJEVE

Ing.Kastriot BICA

BASHKIA MIRDITË

SEKRETAR - BASHKIA MIRD

TABELA E PERSHKRIMIT TE SIPERFAQES KULLUSORE

(Për dhënien në perdorim Sipërfaqe Fond Pyjor, në zbatim të projektit të shpimeve verifikuese në zonat Perlat-Jugor nga kompania )
("**TETE ALBANIA TUNNEL & MINING** " SH.A)

Formulari 2

| ID I Pronës | Ekonomia pyjore/kullosore | Parcela nr. | Bimesia në % Leguminace, graminace etj | Sip.sipas tipit të kullotes në ha | | | Ngarkesa në krere që kullosin | | | | Vlera e kullotës në 000/lekë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Dimerore | Verore | Total | Dhen | Dhi | Të trasha | Total | Ha | Total |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali** | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

PLOTESOI: Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI ABUAPYJEVE

Ing.Kastriot BICA

BASHKIA MIRDITË

INVESTIME TË KRYERA NË VITE

(Për dhënien në perdorim Sipërfaqe Fond Pyjor, në zbatim të projektit të shpimeve verifikuese në zonat Perlat -Jugor nga kompania)
(" **TETE ALBANIA TUNNEL & MINING** " SH.A)

Formulari 3

| ID I Pronës | Përdorimi | Ekonomia pyjore/kullosore | n/Parcela nr. | Sip.totale | Sipërfaqe me punime | Viti i kryerjes së punimeve | Punimi i kryer ne ha/m3 | | | Vlera e investimit në 000 lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Pyllëzim | Përmires | Sist.mal | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

PLOTESOI: Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI ABUAPYJEVE

Ing.Kastriot BICA

BASHKIA MIRDITË

TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT FINANCIAR

(Për dhënien në perdorim Sipërfaqe Fond Pyjor, në zbatim të projektit të shpimeve verifikuese në zonat Perlat-Jugor nga kompania)
(" **TETE ALBANIA TUNNEL & MINING** " SH.A)

Formulari 4

| Perdorimi i territorit | Siperf.në ha | Volu. $m^3$, Lph. | Volum $i/m^3$. | Vlera | | Sipërf. Perdori, per shpim. në ha | Gjatesia e rrugës në km | Gjatesia e përdorim, e linjes në km | Tarifa dhënie ne perdorim lek/km/vit | | | Shuma I lekë | Shuma II lekë | TOTALI I+II lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lek/m3 | Shuma I | | | | 1 | 2 deri 5 | 6 deri 10 | | | |
| 0 | 1 | | 3 | 4 | 5 | 6 | | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| Trungjishte | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Cungishte | 0.966 | 0 | 17 | 600 | 10200 | 0 | 2.147 | 0 | 0 | 50 000 | 0 | 0 | 107 350 | 107 350 |
| Cungishte | 0.129 | | | | | 0.129 | - | 0 | 0 | 96 000 | 0 | 10 200 | 12 384 | 22 584 |
| Shkurre | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kullote | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Bimesi pyjore+Djerr | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Bimesi pyjore+Djerr | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Inproduktive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Bime mjek/med | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjuetia | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Invest realizuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali** | **1.095** | 0 | 0 | 0 | **10 200** | **0.129** | **2.147** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **119734** | **129 934** |

PLOTESOI:

Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI ABUAPYJEVE

Ing.Kastriot BICA

BASHKIA MIRDITË

LISTA PERMBLEDHESE E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË JEPEN NE PERDORIM

(Për dhënien në perdorim Sipërfaqe Fond Pyjor, në zbatim të projektit të shpimeve verifikuese në zonat Perlat- Jugor nga kompania )

("**TETE ALBANIA.TUNEL&MINING**" SH.A)

Formulari 5

| Nr | ID prones | Ekonomia pyjore kullosore | n/Ngastra/nr | Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/kullosor | Sipërfaqja që jepet në përdorim nga fondi pyjor/kullosor | Gjatesia në përdorim km | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Rrugë | Linjë | Tubacion/kanal |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 1 | LE 33 0088/b | Selitë | 88/b | 0 | 0.033 | 0.72 | 0 | 0 |
| 2 | LE 33 0088/d | Selitë | 88/d | 0 | 0.015 | 0.361 | 0 | 0 |
| 3 | LE 33 0089/b | Selitë | 89/b | 0 | 0.015 | 0.244 | 0 | 0 |
| 4 | LE 31 0024/b | Perlat Shebe | 24/b | 0 | 0.066 | 0.822 | 0 | 0 |
| **Totali** | | | | **0** | **0.129** | **2.147** | **0** | **0** |

PLOTESOI:

Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI ABUAPYJEVE

Ing.Kastriot BICA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË**

**DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE MARRËDHËNIEVE ME QYTETARËT**
**SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIME**

**Nr.1107 Prot.** **Rrëshen, më 14/04/2026**

**URDHËR**

**Nr. 183, datë 14/04/2026**

**"PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR TRAJTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "TETE ALBANIA TUNNEL&MINING" SH.A.**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"I ndryshuar , ligjin 57/2020 "Për pyjet" neni 16 dhe 17, Udhëzim nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", VKM 559 datë 29.07.2022; kërkesën me nr.1314 Prot, datë 19.03.2026 të Shoqërisë "Tete Albania Tunnel & Mining";

**URDHËROJ:**

1.Ngritjen e grupit të punës për hartimin e raportit të studimit tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore për kërkim verifikim pikë mineral bakri sipas planimetrisë së kërkesës, nga shoqëria "Tete Albania Tunnel&Mining" sh.a.

2.Përbërja e komisionit do jetë si më poshtë :

| | | |
|---|---|---|
| **1. Eneida** | **Nikolli** | **Pergj. Sekt. Pyjor** |
| **2. Gjovalin** | **Nikolli** | **Ing Sekt. Pyjor** |
| **3. Preng** | **Nikolli** | **Ing Sekt. Pyjor** |

3..Hartimin e relacionit duke reflektuar ndryshimet ligjore sipas VKM Nr.559 datë 29.07.2022

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

**K R Y E T A R I**
**Albert MËLYSHI**

**ME DELEGIM KOMPETENCASH**
**ME VENDIM**
**ZV/KRYETAR**
**Gjergj PRENGA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

TETE
ALBANIA

Nr. 1314 Prot
Dt. 13.03.2026

BASHKIA MIRDITË SEKRETARIA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. ...Prot

Tiranë 17.03.2026

**RI-PËRSËRITJE KËRKESE**
**PËR PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE PËR PROJEKTIT E SHPIMEVE VERIFIKUESE NË ZONËN LEJE MINERARE PERLAT JUGOR**

**<u>Drejtuar</u>** **Drejtuar Bashkisë Mirditë,**
**AGJENCISË SË SHËRBIMEVE BUJQËSORE VETERINERE DHE PYJORE**

**<u>Kërkues</u> :** **Shoqëria "TETE ALBANIA TUNNEL & MINING" sh.a me NUIS: K71627041B** me seli në Rrugën "Sami Frasheri", Kompleksi 'Nobis', Kati 1, Tiranë.

**Baza Ligjore** Ligji nr. 57/2020, "PËR PYJET",
VKM nr.559 dt 29.07.2022 PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM/PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR, PËR VEPRIMTARI EKONOMIKE, SI DHE PËR PRODHIMET DRUSORE DHE JODRUSORE PYJORE

TË NDERUAR !

Shoqëria *"TETE Albania Tunnel & Mining" sh.a.* është një kompani me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e shfrytezimit dhe pasurimit të bakrit në Territorin e Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë e cila ka ndëtur edhe fabrikën e pasurimit të bakrit në minierën e Spaçit.

Në kuadrin e "Projektit të shpimeve verifikuese" për lejen minerare të shfrytëzimit të minierës Perlat – zona minerare nr. 217, shoqëria "Tete Albania Tunnel & Mining" Sh.a., kërkon të realizojë në 43 pika, shpime verifikuese, në prona shtetërore në fshatin Perlat i Epërm, Njësia Administrative Kthellë e Epërme të Bashkisë Mirditë.

Sheshet e pikave të shpimeve ku do të vendosen sondat, zënë një sipërfaqe gjithsej = 30 m$^2$ për çdo shesh, që në total sipërfaqja e përgjithme e shesheve të 43 vende shpimit është **1.290 m$^2$** dhe **2.147** ml rruge.**(9.664,51 m$^2$)**

Pjesa tjetër e shpimeve që do të kryhen, është në prona private dhe marreveshja per akses në këto prona do të sigurohet me marrëveshje mes palëve.

Faleminderit për Bashkëpunimin dhe mirëkuptin tuaj.